

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË  
AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË, ME OBJEKT “MBI  
ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË EKONOMIKO –  
FINANCIARE”, PERIUDHA 01.01.2014 – 30.06.2015.**

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Tiranë, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko – financiare”, për periudhën 01.01.2013 deri 30.06.2014, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 125, datë 21.09.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën nr. 557/10, datë 22.09.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar z. Afrim Bakaj, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Tiranë, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

**A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.**

-Nga auditimi është konstatuar se nga titullari i AKU për vitin 2011 ka dalë udhëzimi “*Mbi procedurat e vendosjes se gjobave, evidentimit, administrimit dhe ndjekjes për arkëtim*” drejtuar për zbatim Drejtorisë Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, Drejtorisë Shërbimeve të Brendshme, Sektorit të Auditit të Brendshëm, Drejtorive Rajonale. Bazuar në ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008 “*Për ushqimin*” i ndryshuar me nr. 74/2013, në nenin 70/4 thuhet se “*Mënyra e vjeljes së gjobave dhe shpërndarja e tyre përcaktohen me vendime të Këshillit të Ministrave me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit*”. Po në këtë ligj në nenin 71 citohet se “*Aktet nënligjore që nxjerr Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në zbatim të këtij ligji, bëhen me propozimin e AKU-së*”. Aktualisht nga AKU nuk ka në zbatim asnjë akt nënligjor të propozuar apo të miratuar në këtë drejtim. Udhëzimi i mësipërm i Titullarit të AKU “*Mbi procedurat e vendosjes se gjobave, evidentimit, administrimit dhe ndjekjes për arkëtim*” nuk është mbështetur në asnjë akt ligjor ose nënligjor të nxjerrë nga Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

-Procesverbalet e mbajtur nga inspektorët e DR të AKU, nuk kanë të përshkruar të dhëna për arkëtimin e gjobave, nr. e llogarisë për derdhjen e detyrimit, apo adresë të institucionit, etj. Mungesa apo mos vendosja e këtyre elementëve në këtë procesverbal e bën të pa mundur arkëtimin e këtyre gjobave. Gjithashtu nuk ka ndarje midis procesverbalit dhe pjesës së vendimmarrjes (vendimi) pasi në një të njëjtin format nuk mund të jetë dhe procesverbali dhe vendimi.

-Rregullorja Brendshme ekzistuese është e miratuar nga Titullari i institucionit, por jo nga Bordi Drejtues, sipas kërkesave të VKM nr. 1081, datë 21.10.2009 “*Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit*” dhe as nga Ministri i Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në kundërshtim me ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008 “*Për ushqimin*” të ndryshuar neni 61, “*Rregullorja e brendshme e funksionimit të AKU-së miratohet me urdhër të ministrit*”. Rregullorja Brendshme aktuale nuk është në përshtatje edhe me strukturën organike të miratuar në gusht të vitit 2013 si dhe asaj të vitit 2014.

***Për këtë është rekomanduar:***

**a**-Në zbatim të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin” të ndryshuar me ligjin nr. 74/2013, nga AKU dhe MBZHRAU të hartohet dhe t’i propozohet Këshillit të Ministrave projekt vendimi mbi “Mënyrën e vjeljes se gjobave dhe shpërndarja e tyre”.

**b**-AKU në zbatim të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar të propozojë aktet nënligjore përkatëse pranë Ministrit të Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave në zbatim të këtij ligji.

**c**-Modeli i procesverbalit të mbajtur nga inspektorët e AKU, të përmbajë dhe plotësojë të dhënat si nr. i llogarisë për derdhjen e detyrimit, apo adresën e institucionit, për të bërë të mundur arkëtimin e këtyre gjobave dhe të ndahet procesverbalit nga pjesa e vendimmarrjes (vendimi) pasi në një të njëjtin format nuk mund të jetë dhe procesverbalit dhe vendimi.

**d**-AKU të hartojë rregullore të re, në përputhje me organigramën e institucionit, e shoqëruar me rregullat dhe detyrat për çdo pozicion pune, sipas përgjegjësisë, referuar ligjit për MFK-në si dhe ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”.

**Deri 31.12.2015**

-Nga auditimi i kryer mbi analizat e produkteve ushqimore për treguesit fiziko-kimikë të çdo produkti ushqimor dhe garantimin e tyre për konsum publik rezulton se treguesit cilësorë të produkteve janë të pandarë nga nënproduktet e tyre, duke sjellë si pasojë vështirësi në përcaktimin e treguesve të produktit nga nënproduktet e tyre, të cilat lidhen edhe me tarifat që arkëtohen për çdo tregues të veçantë që analizohet, kjo në kundërshtim me udhëzimin nr. 8, datë 08.05.2007 “Mbi tarifat e të ardhurave dytësore, të aplikuara nga institucionet e vartësisë së Ministrisë Bujqësisë”.

**Për këtë është rekomanduar:**

MBZHRAU dhe Drejtoria e Përgjithshme e AKU, të marrë masa për hartimin dhe përcaktimin e standardeve ushqimore të çdo produkti në veçanti dhe për nën produktet e tyre, konform standardeve të Komunitetit Evropian që shoqërojnë produktet që importohen, si dhe përcaktimin e tarifave përkatëse të tyre.

**Menjëherë**

-Nga auditimi u konstatua se asgjësimi i produkteve të sekuestruar nga operatorët e biznesit, kryhej në ambiente të hapura, pa një komision autorizuar nga titullari, në momentin që kryhet asgjësimi për asgjësimin e produkteve të sekuestruara dhe nuk ka një dispozitë rregullative, ku të përcaktohet procedura e asgjësimit dhe dokumentacioni përkatës që duhet mbajtur.

**Për këtë është rekomanduar:**

Nga Drejtoria Rajonale AKU, të merren masa për hartimin e miratimin nga MBZHRAU të një dispozite rregullative, ku të përcaktohet procedura e asgjësimit dhe dokumentacioni përkatës që duhet mbajtur për asgjësimin e produkteve të sekuestruara të operatorëve të biznesit.

**Menjëherë**

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1.** Nga auditimi i procedurave të punësimit rezultoi se nga DRAKU Tiranë është likuiduar vlera prej 1,077,973 lekë, përfituar nga 2 punonjës të larguar nga puna pranë kësaj drejtorie sipas vendimit të gjykatës, si rezultat i mos apelimit të vendimeve të Gjykatës, në kundërshtim me nenin 442/a dhe 452 të Kodit të Procedurës Civile dhe draft rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e AKU-së, nenin 36, detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit

Juridik, germa b) “Përfaqëson me autorizim të veçantë Drejtorinë e Përgjithshme në proceset gjyqësore ku ajo është palë” dhe ngarkojnë me përgjegjësi Sektorin Juridik në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së. Likuidimi i shumës së mësipërme është gjithashtu në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 2, datë 06.12.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxheti” pika 62.

**Për këtë është rekomanduar:**

Drejtorinë e Përgjithshme të AKU të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë ndaj punonjësve të Sektorit Juridik për mos apelimin e vendimeve të Gjykatës për vlerën e përfituar prej 1,077,973 lekë, nga 2 punonjësit e larguar nga puna pranë kësaj drejtorie.

**Menjëherë**

2-Nga auditimi i gjobave të vendosura nga DRAKU Tiranë për periudhën 01.01.2014, deri me 30.06.2015, rezultoi se nuk janë hedhur në sistemin sistemin AKU-net, nuk janë kontabilizuar, nuk janë ndjekur dhe nuk janë arkëtuar gjoba me vlerën, prej **19,831,000** lekë, në kundërshtim me udhëzimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKU nr. 6 17/1, datë 23.05.2011, “Mbi procedurat e vendosjes së gjobave, evidentimit, administrimit dhe ndjekjes për arkëtim”, i dërguar për tu zbatuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Drejtoritë Rajonale.

**Për këtë është rekomanduar:**

DRAKU Tiranë në bashkëpunim me AKU për gjobat e vendosura në vlerën 19,831,000 lekë të marrë masat për i hedhur në sistemin AKU-net, ti kontabilizojë ato, të ndjekë ecurinë e tyre në të gjithë fazat ligjore deri në arkëtimin e plotë të tyre.

**Menjëherë**

3-Drejtoria Rajonale e AKU-së, *nuk ka të autorizuar laboratorin*, për kryerjen e analizave në kundërshtim me Ligjin e “Ushqimit” me nr. 9863, datë 28.01.2008, nenet 44 dhe 45, ku përcaktohet qartësisht se, *autorizimi i laboratorit duhet të behët çdo vit*. Mungon lista e laboratorëve të autorizuar të kontrolleve, ku përcaktohet tipi i laboratorit dhe analizat, që janë të autorizuar të kryejnë. Certifikimi i laboratorit është detyrim ligjor të bëhet çdo vit dhe *miratohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë. Moskryerja e analizave nga laboratorët e autorizuar të kontrollit zyrtar të tregut ushqimor, është me pasoja për kontrollin dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës sa trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të auditimit nga faqja 19-20.*

**Për këtë është rekomanduar:**

Drejtoria Rajonale AKU në bashkëpunim me AKU dhe MBZHRAU, të marrë masa për certifikimin e laboratorit çdo vit dhe analizat që janë të autorizuar të kryejnë, për të bërë të mundur kontrollin e tregut ushqimor sipas ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008, “Për Ushqimin”.

**Menjëherë**

4-U konstatua se Inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tiranë, të cilët realizojnë inspekte ndaj operatorëve të biznesit (OB), në procesverbalet e mbajtura kanë mangësi pasi nuk *përmbajnë* informacione të hollësishme për veprimet e inspektimit, si kohën e ushtrimit të inspektimit (*orari i fillimit dhe i përfundimit të inspektimit*), gjetjet e tij, vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit, si dhe nuk shoqërohet me liste-verifikimin, që plotësohet gjatë inspektimit, veprime këto në kundërshtim me ligjin e nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në

*Republikën e Shqipërisë”, neni 45, pika 3 dhe ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008, “Për Ushqimin” neni 68 sa trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar nga faqja 20-41.*

***Për këtë është rekomanduar:***

Drejtoria Rajonale Tiranë të marrë masa e duhura në mënyrë që inspektorët që realizojnë inspektime ndaj operatorëve ekonomikë të plotësojnë procesverbalet me të gjithë elementë e tij, me informacione të hollësishme për veprimet e inspektimit, të gjitha rubrikat e detyrueshme që përmban formulari i standardizuar i procesverbalit, në përputhje me ligjin e nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008, “Për Ushqimin”.

***Menjëherë***

5-Nga auditimi rezultoi se ndërtesa ku janë vendosur dhe kryen aktivitetin Drejtoria Rajonale AKU nuk është në Regjistrin e Pronave të Paluajtshme, sipas kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, nuk është inventarizuar dhe nuk është pasqyruar në “Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara” të pasqyrave financiare, në kundërshtim me urdhrin e Ministrit të BZHRAU sa trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të auditimit nga faqja 11-13.

***Për këtë është rekomanduar:***

Drejtoria Rajonale në bashkëpunim me AKU, të përgatitë dokumentacioni ligjor të pronësisë për objektet që i janë vënë në dispozicion nga MBZHRAU në zbatim të VKM, për regjistrimin e tyre sipas kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ti pasqyrojë ato në “Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara”.

***Menjëherë***

### **C. MASA DISIPLINORE.**

**C/1.** Bazuar në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” të Kreut X “Disiplina në Shërbimin Civil” të ligjit nr. 152, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, Vendimit të KM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, Kreu II “Procedura disiplinore”, si dhe Udhëzimit të Departamentit të Administratës Publike nr. 1, datë 02.04.2014 “Elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, i rekomandoj Titullarit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhënien e masave disiplinore.

***“Vërejtje” për:***

**1-Z. T. K,** me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale, për mangësitë e konstatuara dhe përgjegjësinë për mos administrimin, ndjekjen dhe arkëtimin e gjobave, të vendosur operatoreve të biznesit, në kundërshtim me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 617, datë 23.05.2011, “Mbi procedurat e vendosjes së gjobave, evidentimin, administrimin dhe ndjekjes gjobave”, pikat 9, 10, “Drejtorët Rajonal, të bëjnë përpjekje për vjeljen dhe arkëtimin e këtyre gjobave, në mënyrë vullnetare dhe nëse nuk bëhet e mundur, më pas nëse ato nuk arkëtohen në këtë mënyrë mbasi të jenë plotësuar afatet ligjore Drejtorët Rajonal, ..... në bashkëpunim me sektorin Juridik të Drejtorisë së Përgjithshme do të bëjnë ndjekjen e arkëtimin të gjobës në rrugë ligjore”, urdhrin nr. 617/1, datë 23.05.2011, “Për procedurat e gjobave”, ku shprehet përgjegjësia e Drejtorëve Rajonalë, dhe punonjësit e ngarkuar për ndjekjen e mbarëvajtjes së gjobave që nga momenti i vendosjes deri në vjeljen e tyre.

**2-Znj. R. J** me detyrë inspektore në Drejtorinë Rajonale Tiranë, për mangësitë e konstatuara dhe përgjegjësinë për mos administrimin, ndjekjen dhe arkëtimin e gjobave, të vendosur operatoreve të biznesit, në kundërshtim me urdhrin e Drejtorit nr. 1106, datë 14.10.2014, “Mbi krijimin e një regjistri të veçantë mbi ecurinë e arkëtimit të gjobave të vendosura nga inspektorët e DRAKU”, pika 3 “në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme, të ndiqen të gjitha hapat për arkëtimin e gjobave”.

**3-Z. A. D** me detyrë inspektor në Drejtorinë Rajonale Tiranë, për mangësitë e konstatuara dhe përgjegjësinë për mos administrimin, ndjekjen dhe arkëtimin e gjobave, të vendosur operatoreve të biznesit, në kundërshtim me urdhrin e Drejtorit nr. 1106, datë 14.10.2014, “Mbi krijimin e një regjistri të veçantë mbi ecurinë e arkëtimit të gjobave të vendosura nga inspektorët e DRAKU”, pika 3 “në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme, të ndiqen të gjitha hapat për arkëtimin e gjobave”.

**4-Znj.V. K**me detyrë Përgjegjëse Sektorit Juridik, në Drejtorinë e Përgjithshme AKU, për mangësitë e konstatuara dhe përgjegjësinë për mos administrimin, ndjekjen dhe arkëtimin e gjobave, të vendosur operatoreve të biznesit, në kundërshtim me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 617, datë 23.05.2011, “Mbi proceduarat e vendosjes së gjobave, evidentimin, administrimin dhe ndjekjes gjobave”, pikat 9, 10, “Drejtorët Rajonal, të bëjnë përpjekje për vjeljen dhe arkëtim e këtyre gjobave, në mënyrë vullnetare dhe nëse nuk bëhet e mundur, më pas nëse ato nuk arkëtohen në këtë mënyrë mbasi të jenë plotësuar afatet ligjore Drejtorët Rajonal, ..... në bashkëpunim me sektorin Juridik të Drejtorisë së Përgjithshme do të bëjnë ndjekjen e arkëtimit të gjobës në rrugë ligjore”,

**5-Znj. L. K** me detyrë specialiste Sektorit Juridik në Drejtorinë e Përgjithshme AKU, për mangësitë e konstatuara dhe përgjegjësinë për mos administrimin, ndjekjen dhe arkëtimin e gjobave, të vendosur operatoreve të biznesit, në kundërshtim me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 617, datë 23.05.2011, “Mbi proceduarat e vendosjes së gjobave, evidentimin, administrimin dhe ndjekjes gjobave”, pikat 9, 10, “Drejtorët Rajonal, të bëjnë përpjekje për vjeljen dhe arkëtim e këtyre gjobave, në mënyrë vullnetare dhe nëse nuk bëhet e mundur, më pas nëse ato nuk arkëtohen në këtë mënyrë mbasi të jenë plotësuar afatet ligjore Drejtorët Rajonal, ..... në bashkëpunim me sektorin Juridik të Drejtorisë së Përgjithshme do të bëjnë ndjekjen e arkëtimit të gjobës në rrugë ligjore”,

**6-Z. G. Dh**, me detyrë specialist i Sektorit Juridik në Drejtorinë e Përgjithshme AKU, për mangësitë e konstatuara dhe përgjegjësinë për mos administrimin, ndjekjen dhe arkëtimin e gjobave, të vendosur operatoreve të biznesit, në kundërshtim me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 617, datë 23.05.2011, “Mbi proceduarat e vendosjes së gjobave, evidentimin, administrimin dhe ndjekjes gjobave”, pikat 9, 10, “Drejtorët Rajonal, të bëjnë përpjekje për vjeljen dhe arkëtim e këtyre gjobave, në mënyrë vullnetare dhe nëse nuk bëhet e mundur, më pas nëse ato nuk arkëtohen në këtë mënyrë mbasi të jenë plotësuar afatet ligjore Drejtorët Rajonal, ..... në bashkëpunim me sektorin Juridik të Drejtorisë së Përgjithshme do të bëjnë ndjekjen e arkëtimit të gjobës në rrugë ligjore” sa trajtuar me hollësisht në Raportin Përfundimtar të auditimit nga faqja 22-26.

**7-Tu tërhiqet vëmendja inspektorëve:** A. H, A.Sh, A. Sh, A. K, A. M, B. O, B.B, D.P, D. D, D. K, E. C, E. C, E. M, E. D, E. V, E. A, E. Sh, E. B, F. R, G. H, G. P, I. O, I.K, I. Z, J. C, L. A, L. B, L. Ç, L. Zh, L. Z, M. D, M. M, M. B, M. T, N. H, N. C, N. K, S. S, S. N, Sh. K, T.

K, V. Zh, Z. M, për mangësitë dhe shkeljet e konstatua në praktikat e inspektimit pasi kanë kryer veprime procedurale jashtë kohëzgjatjes, nuk kanë plotësuar listë verifikimet, nuk kanë korrigjuar parregullsitë brenda afateve të përcaktuara, kjo në kundërshtim me ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenet 29, 45, 48 dhe kanë kryer veprime në kundërshtim me kërkesat e gjurmëshmërisë të përcaktuara më nenin 25 të ligjit nr. 9863 datë 28.01.2008, “Për ushqimin” i ndryshuar, nenin 68 “kundërvajtjet administrative” sa trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të auditimit nga faqja 26-47.

## **E. TË TJERA**

Ky auditim është vlerësuar shumë i dobët nga Kryetarit i KLSH-së. Nisur nga sa më sipër në mënyrë që të plotësohen gjetjet dhe të mbulohen të gjitha zonat me risk, kjo periudhë do të riauditohet nga KLSH-ja, në auditimin në vijim që do të ushtrohet në këtë subjekt, me objekt funksionimin dhe performancën e strukturave përgjegjëse për mbikëqyrjen e sigurisë ushqimore, mbrojtjes së konsumatorit, mbrojtjes së bimëve dhe shëndetit të kafshëve.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Valdete Berisha, përgjegjëse grupi dhe Hektor Kosova, më tej materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Zbatimit të Standardeve, Drejtori i Departamentit dhe Drejtori i Përgjithshëm.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**